



Ministria e Punëve të Brendshme  
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova  
Ministry of Internal Affairs

REPUBLIKA E KOSOVËS /  
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA E KOSOVËS  
VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

DEPARTAMENTI I INSPEKTIMIT

INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS  
POLICIJSKI INSPEKTORAT KOSOVA  
POLICE INSPECTORATE OF KOSOVO  
BRENDSHME  
03-364  
f.15  
14.10.2016

Inspektorati Policor i Kosovës  
Policijski Inspektorat Kosova  
Police Inspectorate of Kosovo

## Raporti i Inspektimit Nr: 6 /2016

# VLERËSIMI I PERFORMANCËS POLICORE GJATË FILLIMIT TË NDËRRIMIT NGA ORA 08-16 NË STACIONET POLICORE TË KATEGORISË “A” TË DATËS 14.10.2016



HILMI MEHMETI

Kryeshef Ekzekutiv i IPK- së

  


## SHKURTESAT

---

<b>IPK</b>	<b>Inspektorati Policor i Kosovës</b>
<b>PK</b>	<b>Policia e Kosovës</b>
<b>DPP</b>	<b>Drejtoria e Përgjithshme e Policisë</b>
<b>DHK</b>	<b>Departamenti i Hetimit të Krimit</b>
<b>DI</b>	<b>Departamenti i Inspektimeve</b>
<b>DH</b>	<b>Departamenti i Hetimeve</b>
<b>DRP</b>	<b>Drejtoria Rajonale Policore</b>
<b>NJSO</b>	<b>Njësia Speciale Operative</b>
<b>NJRSH</b>	<b>Njësia për Reagim të Shpejt</b>
<b>UA</b>	<b>Udhëzimi Administrativ</b>
<b>UO</b>	<b>Urdhër Operativ</b>
<b>PO</b>	<b>Plan Operativ</b>
<b>PSO</b>	<b>Procedurat Standarde të Operimit</b>

# PËRMBAJTJA

---

1. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE .....	(3-3)
2. HYRJE .....	(4-5)
3. PËRMBLEDHJE E TË GJETURAVE .....	(6-11)
3.1 Vlerësimi i kapaciteteve aktive dhe respektimi i orarit të punës	
3.2 Vlerësimi i respektimit të standardit për bartjen e uniformës dhe pajisjeve	
3.3 Vlerësimi i planeve të patrullave për ndërrimin	
3.4 Vlerësimi i nivelit të sigurisë të stacioneve policore	
4. PËRFUNDIMET .....	(12-12)
5. REKOMANDIMET .....	(13-13)
6. PLANI I VEPRIMIT NË PËRMBUSHJEN E REKOMANDIMEVE .....	(14-14)

## 1. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

---

1.1. Strukturimi organizativ i Policisë së Kosovës ka paraparë kategorizimin e stacioneve policore të kategorisë: "A", "B" dhe "C". Fokus i inspektimit të jashtëzakonshëm kanë qenë stacionet policor të kategorisë "A" që njëherit konsiderohen si stacione me staf më të shumtë në numër kundrejt stacioneve të kategorive tjera. Në çdo DRP të PK-së aktualisht ekziston nga një stacion i kategorisë "A", përveç, DRP Prishtinës që ka tri stacione me këtë kategori.

1.2. Duke qenë se këto stacione kanë për detyrë të parandalojnë rrezikun ndaj qytetarëve dhe ta mbajnë rendin e sigurinë publike, IPK-ja ka zhvilluar inspektim mbi performancën e pjesëtarëve të PK-së së stacioneve policore të kategorisë "A" në gjithsej njëmbëdhjetë (11) stacione.

1.3. Lidhur me mbulueshmërinë e ndërrimit përkatës me personel të mjaftueshëm, inspektimi ka gjetur se ndërrimet kanë qenë mirë të mbuluara me personel, përveç St. Policor Pejë dhe Qendra Prishtinë që kanë pasur numër më të madh të punonjësve jashtë detyre si pasojë e pushimeve të ndryshme dhe St. Policor Ferizaj që ka pasë të angazhuar personelin për implementimin e planit operativ "Lojërat e Fatit".

1.4. Stacionet policore të inspektuara kanë prezantuar oraret e ndërrimeve dhe angazhimet e personelit gjatë atij orari, mirëpo, inspektimi ka gjetur se në disa stacione nuk hartohet një raport paraprak që i dorëzohet mbikëqyrësit të ndërrimit vijues. Po ashtu, gjatë inspektimit është konstatuar se disa stacione përpilojnë evidenca për vijueshmërinë në punë të personelit, mirëpo, disa stacione tjera nuk e aplikojnë këtë mënyrë të prezencës së personelit në punë.

1.5. Standardi i bartjes së uniformës del të jetë i mirë tek shenja e PK-së/flamuri, këmisha zyrtare dhe kapela. Mirëpo, respektimi i rregullit për përdorimin e pjesëve tjera të uniformës del të jetë më keq sidomos tek bexhi zyrtar dhe shufra për mbajtjen e kravatës.

1.6. Prej të gjitha pajisjeve, zyrtarët policor në nivel të plotë kanë pasur armën zyrtare dhe këllëfin e saj. Mirëpo, një numër i konsideruar i zyrtarëve policor nuk kanë prezantuar bateritë për ndriçim dhe radion komunikuese si pajisje të nevojshme për kryerjen e detyrave policore.

1.7. Niveli i sigurisë në këto stacione është vlerësuar si i mjaftueshëm. Nga 11 stacione të inspektuara nëntë prej tyre kanë pasë të angazhuar policin e parë apo të sigurisë; shtatë prej tyre janë të pajisura me sistemin e monitorimit me kamera; tetë prej tyre kanë të rregulluar rrethojat rreth stacioneve. Nivel të mjaftueshëm/keq të sigurisë kanë dy stacione policore: Peja dhe Gjilani. Kjo për shkak të afërsisë së tyre me rrugën kryesore, frekuentimit të madh të qytetarëve dhe mos sigurimin e objektit me asnjë rrethojë.

## 2. HYRJE

---

2.1. Bazuar në Ligjin për IPK-në, me autorizim të Kryeshefit Ekzekutiv është zhvilluar inspektim i jashtëzakonshëm për të vlerësuar performancën policore gjatë fillimit të ndërrimit nga ora 08-16 në Stacionet Policore të kategorisë A të datës 14.10.2016.

2.2. Qëllimi i organizimit dhe funksionalizimit të këtij inspektimi ka qenë vlerësimi i performancës në Stacionet Policore të kategorisë A gjatë ndërrimit të paradites, duke përfshirë vijueshmërinë në punë të zyrtarëve policor, kapacitetet njerëzore, standardet e bartjes së uniformës, përgatitja e orareve të punës, raportimi si dhe niveli i sigurisë së stacioneve policore.

2.3. Objekt i këtij inspektimi ishin stacionet policore të kategorisë A të shpërndara në të gjitha Drejtoritë Rajonale.

2.4. Lidhur me këtë inspektim janë vënë këto objektiva:

- Vlerësimi i kapaciteteve aktive dhe respektimi i orarit të punës;
- Vlerësimi i respektimit të standardit për bartjen e uniformës dhe pajisjeve policore;
- Vlerësimi i planeve të patrullave policore;
- Vlerësimi i nivelit të sigurisë së Stacioneve Policore.

2.5. Inspektimi në këtë fushë do të kontribuojë në:

- përmirësimin dhe ngritjen e vazhdueshme të performancës së punonjësve në kuadër të stacioneve policore;
- përmirësimin e shërbimeve duke siguruar shkallë më të lartë të sigurisë për qytetar;
- ngritjen e profesionalizimit, disiplinës dhe përgjegjësisë së zyrtarëve policorë të angazhuar në detyrë për të qenë efektiv dhe efikas;
- ngritjen e shkallës së sigurisë për pjesëtarët dhe pasurinë e policisë gjatë kryerjes së detyrave të tyre;

2.6. Metodologjia e përdorur gjatë këtij aktiviteti ka qenë që përmes këtij inspektimi të vlerësohet performanca e PK-së në stacionet policore, duke:

- intervistuar menaxherët në detyrë me grada më të larta drejtuese, shefat e ndërrimeve;
- kontrolluar/inspektuar respektimin e standardit për bartjen e uniformës dhe pajisjeve policore;
- kontrolluar dokumentacionin me të cilin pasqyrohet puna e stacioneve (oraret e ndërrimit, planet operative, raportet e ndërrimeve dhe regjistrat e hyrje-daljeve).

2.7. Programi i punës inspektuese ka paraparë zhvillimin e aktivitetit inspektues në terren në orët e mëngjesit të datës 14.10.2016, me fillim nga ora 06:45 për stacionet policore të cilat ndërrimin e paradites e fillojnë në ora 07:00 si dhe në Ora 07:45 për stacionet policore të cilat ndërrimin e paradites e fillojnë në ora 08:00.

2.8. Inspektimi është përqendruar në këto drejtime apo fusha kryesore:

- Burimet Njerëzore dhe kapacitetet aktive policore
- Evidentimi i prezencës në detyrë
- Pranim-Dorëzimi i detyrës nga ndërrimi paraprak
- Siguria e stacioneve policore, vendosja dhe funksionalizimi i pajisjeve teknologjike (kamerat e vëzhgimit)
- Pajisjet dhe standardet e uniformës

2.9. Inspektimi është bazuar në këtë kuadër ligjor:

- Ligjin për IPK-në (nr. 03/L-231),
- Udhëzimin Administrativ për Inspektime në PK (nr. 11/2011- MPB),
- Autorizimin zyrtar të lëshuar për kryerjen e inspektimit në PK (nr. 21/2015- MPB).

2.10. Puna e inspektorëve është mbështetur në dokumentet vijuese:

- Ligji për Policinë e Kosovës (nr. 04/L-076).
- Rregullore 30/2015 për standardet e uniformës
- Struktura organizative- Lista e shpërndarjes së personelit.
- Orari ditor i punës dhe planet operative.

### 3. TË GJETURAT

---

#### 3.1. Vlerësimi i kapaciteteve aktive dhe respektimi i orarit të punës

3.1.1 Orari i punës në Stacionet Policore të PK-së është i organizuar varësisht natyrës së punës të cilën e kryejnë zyrtarët policor në njësitë përkatëse, ku kryesisht kemi orarin administrativ të punës i cili fillon në ora 8:00 dhe përfundon në ora 16:00 si dhe orarin e punës të organizuar në ndërrime, orar të cilit i përgjigjen zyrtarët policor të cilët janë të angazhuar në Sektorë si dhe zyrtarët policor të caktuar në ekipet reaguese.

3.1.2 Sa i përket caktimit të orarit të punës të organizuar në ndërrime, Inspektorët kanë vërejtur se ky orar nuk është unik në të gjitha stacionet policore të PK-së, pra, ka dallime nga njëri stacion policor në tjetrin ku në disa stacione orari i punës në ndërrimin e parë fillon në ora 07:00 dhe përfundon në ora 15:00 kurse në stacionet tjera policore orari i punës në ndërrimin e parë fillon në ora 08:00 dhe përfundon në ora 16:00.

3.1.3 Përveç dallimeve në orarin e punës në mes stacioneve policore, Inspektorët kanë vërejtur se ka dallime edhe brenda një stacioni policor, ku ekipet reaguese orarin e punës në ndërrime e kanë të organizuar 07:00-15:00; 15:00-23:00 dhe 23:00-07:00, kurse sektorët orarin e punës e kanë të organizuar: 08:00-16:00 dhe 16:00-24:00, pra punojnë në dy ndërrime. Por kemi edhe raste kur sektorët e kanë orarin fleksibil (siç ishte rasti me stacionin policor në Pejë) që do të thotë se jo të gjithë zyrtarët policor të sektorëve fillojnë punën në të njëjtën kohë.

3.1.4 Gjatë procesit të inspektimit të zhvilluar në orët e mëngjesit të datës 14 tetor 2016, inspektorët janë pajisur nga mbikëqyrësit e ndërrimeve, me kopje të orareve të angazhimit të personelit policor dhe të strukturimit organizativ të personelit. Në përputhje me oraret ditore të punës është verifikuar prezenca e vijueshmërisë në punë e punonjësve policorë.

3.1.5. Bazuar në oraret e angazhimit të personelit, dokumente këto të nënshkruara nga mbikëqyrësit e ndërrimeve, në kohën kur është zhvilluar inspektimi, në detyra kanë qenë të angazhuar gjithsej 447 punonjës, përfshirë: 5 major, 13 kapiten, 23 toger, 51 rreshter dhe 355 polic, kurse 138 punonjës nuk kanë qenë në detyrë. Janë evidentuar katër (4) stacione policore të cilat kanë patur numër më të madh të punonjësve jashtë detyre (Peja, Ferizaj, "Jugu" Prishtinë dhe "Qendra" Prishtinë), (shih tabelën nr. 1).

3.1.6 Deri te ky numër i personelit jashtë detyre ka ardhë si rezultat i pushimeve qoftë atyre vjetore, me kompensim apo i pushimeve mjekësore. Mirëpo, duhet theksuar se në stacionin policor në Ferizaj personeli jashtë detyre nuk ishte si rezultat i pushimeve por, pasi që në këtë stacion policor kishte filluar Planin Operativ "Lojërat e Fatit" dhe i cili implementohej në orët e mbrëmjes duke filluar nga ora 20:00 ku edhe ishin të angazhuar zyrtarët policor nga ky stacion. Në Planin Operativ "Lojërat e Fatit" janë të specifikuar të gjithë akterët të cilët marrin pjesë në realizimin e këtij plani duke përfshirë inspektoratet si: komunale, regjionale dhe qendrore, njësia për hetimin e krimeve ekonomike si dhe zyrtarët policor nga stacioni policor i Ferizajt duke precizuar njësitë policore brenda stacionit si dhe numrin e zyrtarëve policor. Gjithashtu duhet theksuar se edhe në stacionin policor "Qendra" Prishtinë deri te ky numër i madh i zyrtarëve jashtë detyre ka ardhë si rezultat i angazhimit të dhjetë (10) zyrtarëve policor në togun rezervë, tog i cili menaxhohet nga Drejtoria Rajonale Prishtinë.

Tabela nr. 1. Kapacitetet e burimeve njerëzore të stacioneve policore (14.10.2016)						
Stacioni Policor	Personeli në detyrë					Personeli jashtë detyre
	Major	Kapiten	Toger	Rresht	Polic	
Gjilan	1	2	1	4	33	3
Leposaviq	1		2	1	23	5
Prizren	1	2	3	8	33	4
Peja		1	4	6	35	19
Mitrovica Jugu		2	1	8	29	2
Mitrovica Veri	2	-	3	1	38	7
Gjakova		1	2	3	33	6
Ferizaj		1	-	4	17	37
“Veri” Prishtinë		1	1	3	37	5
“Jugu” Prishtinë		3	2	7	44	28
“Qendra” Prishtinë		-	4	6	33	22
<b>Totali</b>	<b>5</b>	<b>13</b>	<b>23</b>	<b>51</b>	<b>355</b>	<b>138</b>
<b>Totali i personeli të uniformuar në detyrë</b>	<b>447</b>					

### 3.2. Vlerësimi i respektimit të standardit për bartjen e uniformës dhe pajisjeve

3.2.1. Fokus i inspektimit gjatë ndërrimit ditor (dt. 14.10.2016) ka qenë edhe respektimi i standardeve që lidhen me uniformën policore. Kushtet e përgjithshme që kanë të bëjnë me standardet e bartjes së uniformës dhe pajisjeve policore janë të përcaktuara me Rregulloren Nr. 30/2015. Lidhur me këtë është bërë kontrollimi i zyrtarëve policor të stacioneve policore të kategorisë “A” që kanë qenë në detyrë gjatë ndërrimit përkatës dhe informatat janë prezentuar në formularë standard, të cilët janë nënshkruar edhe nga vet ata. Sa i përket respektimit të standardeve të bartjes së uniformës është konstatuar se nga 242 zyrtarë policor, beixin e kanë prezentuar 80 prej tyre, numri identifikues nga i gjithë totali i të kontrolluarve nuk është hasur vetëm te një zyrtar policor në Stacionin Policor të Ferizajt; për mbajtjen e shufrës së kravatës këtë kriter e kanë plotësuar 142 veta nga gjithsej 242 z. policor; pantallonat zyrtar nuk i ka pasur një zyrtar policor; ndërsa këpucët zyrtarë nuk i kanë pasur dy zyrtarë policor. Sa i përket pjesëve tjera të uniformës (shenja PK/Flamuri; këmisha zyrtarë; kapela) del që ky standard të jetë në nivel të kënaqshëm. Duhet cekur se për ‘beixin zyrtar’ dhe ‘shufrën e kravatës’, zyrtarët policor kanë pasur ankesa për shkak se janë dëmtuar (për më shumë shih tabelën nr. 2).

Tabela nr. 2. Niveli i pajisjes së punonjësve me uniformën e nevojshme zyrtarë (14.10.2016)								
Stacioni Policor	Numri i pajisjeve të identifikuara në raport me numrin e zyrtarëve të inspektuar							
	Bexhi zyrtar	Shenja e PK/Flamuri	Numri id/Spaleta	Shufra e kravatës	Këmishë zyrtarë <sup>1</sup>	Pantallona zyrtar	Këpucë zyrtarë	Kapelë
Mitrovica Jugu	8 (25)	25 (25)	25 (25)	15 (25)	25 (25)	25 (25)	24 (25)	25 (25)
Mitrovica Veri	3 (36)	36 (36)	36 (36)	30 (36)	36 (36)	35 (36)	35 (36)	36 (36)
Prizren	11 (32)	32 (32)	32 (32)	19 (32)	32 (32)	32 (32)	32 (32)	32 (32)
Pejë	8 (19)	19 (19)	19 (19)	11 (19)	19 (19)	19 (19)	19 (19)	19 (19)
Leposaviçi	2 (20)	20 (20)	20 (20)	6 (20)	20 (20)	20 (20)	20 (20)	20 (20)
Gjilan	3 (9)	9 (9)	9 (9)	7 (9)	9 (9)	9 (9)	9 (9)	9 (9)
Gjakova	10 (18)	18 (18)	18 (18)	11 (18)	18 (18)	18 (18)	18 (18)	18 (18)
Ferizaj	6 (20)	20 (20)	19 (20)	10 (20)	20 (20)	20 (20)	20 (20)	20 (20)
“Veri” Prishtinë	7 (19)	19 (19)	19 (19)	5 (19)	19 (19)	19 (19)	18 (19)	19 (19)
“Jugu” Prishtinë	7 (9)	9 (9)	9 (9)	2 (9)	9 (9)	9 (9)	9 (9)	9 (9)
“Qendra” Prishtinë	15 (35)	35 (35)	35 (35)	26 (35)	35 (35)	35 (35)	35 (35)	34 (35)
Gjithsej	80 (242)	242 (242)	241 (242)	142 (242)	242 (242)	241 (242)	240 (242)	242 (242)

Vërejtje: Numrat e paraqitur brenda kllapave tregojnë numrin e zyrtarëve të inspektuar, kurse jashtë kllapave numrin e zyrtarëve që e kanë pas pajisjen.

3.2.2. Për kryerjen e detyrave operative, zyrtarët policorë kanë në shfrytëzim pajisje të nevojshme policore. Inspektorët kanë kontrolluar pajisjet e 242 zyrtarëve dhe po ashtu, informatat i kanë prezentuar në formularë standard të nënshkruar më pas nga zyrtarët

<sup>1</sup> Në këtë është përfshirë cila do nga veshjet e sipërme, varësisht nga sezoni i përdorimit të tyre



policorë. Prej të gjitha pajisjeve, zyrtarët policor vetëm mbajtjen e armës së zjarrit dhe këllëfit të armës e kanë paraqitur në nivel të plotë. Ndërsa, nga 242 zyrtarë policor 226 prej tyre kanë prezantuar ID; 239 rripin zyrtar; karikatorin rezervë 239; shufrat 224; 222 sprejin; 105 bateritë; 226 prangat dhe 162 pajisjen e radios me mbajtës (për më shumë shih tabelën 3).

Tabela nr. 3. Niveli i pajisjes së zyrtarëve policorë me pajisjet e nevojshme zyrtare (14.10.2016)										
	Numri i pajisjeve të identifikuara në raport me numrin e zyrtarëve të inspektuar									
	ID	Rrip	Armë zjarri	Këllëf arme	Karikatori	Shufra	Sprej	Bateri dore	Pranga	Radio
Mitrovica Jugu	21(25)	24(25)	25(25)	25(25)	25(25)	24(25)	23(25)	14(25)	24(25)	22(25)
Mitrovica Veri	31(36)	36(36)	36(36)	36(36)	35(36)	31(36)	31(36)	31(36)	31(36)	31(36)
Prizren	32(32)	30(32)	32(32)	32(32)	31(32)	28(32)	28(32)	2(32)	31(32)	26(32)
Pejë	19(19)	19(19)	19(19)	19(19)	19(19)	19(19)	19(19)	5(19)	19(19)	8(19)
Leposaviç	17(20)	20(20)	20(20)	20(20)	20(20)	20(20)	19(20)	16(20)	19(20)	7(20)
Gjilan	8(9)	9(9)	9(9)	9(9)	9(9)	9(9)	9(9)	0(9)	9(9)	6(9)
Gjakova	18(18)	18(18)	18(18)	18(18)	17(18)	15(18)	15(18)	6(18)	15(18)	13(18)
Ferizaj	17(20)	20(20)	20(20)	20(20)	20(20)	19(20)	19(20)	4(20)	19(20)	11(20)
“Veri” Prishtinë	19(19)	19(19)	19(19)	19(19)	19(19)	17(19)	17(19)	8(19)	18(19)	10(19)
“Jugu” Prishtinë	9(9)	9(9)	9(9)	9(9)	8(9)	8(9)	8(9)	2(9)	8(9)	3(9)
“Qendra” Prisht.	35(35)	35(35)	35(35)	35(35)	35(35)	34(35)	34(35)	17(35)	33(35)	25(35)
Gjithsej	226 (242)	239 (242)	242 (242)	242 (242)	239 (242)	224 (242)	222 (242)	105 (242)	226 (242)	162 (242)

### 3.3. Vlerësimi i planeve të patrullave për ndërrimin

3.3.1 Inspektorët kanë qenë të interesuar për performancën policore në vijueshmërinë në punë, mbajtjen e orareve të angazhimit në detyrë të burimeve njerëzore duke përfshirë hartimin dhe zbatimin e planeve të patrullimit, dhe raportimin mbi kryerjen e detyrave nga ndërrimi paraprak. Sa i përket vijueshmërisë në punë inspektimi ka gjetur se evidentimi mbi vijueshmërinë në punë të punonjësve nuk aplikohet njëjtë në të gjitha stacionet policore, pasi që në disa stacione aplikohet evidentimi i prezencës së punonjësve në punë përmes nënshkrimit të listave, kurse në stacionet tjera prezenca e punonjësve në punë evidentohet vetëm në oraret e punës (ndërrimit). (shih tabelën nr. 4)

3.3.2 Të gjitha stacionet policore kanë prezantuar oraret e angazhimit të personelit në detyrë duke precizuar edhe aktivitetet në të cilat do të jenë të angazhuar personeli gjatë këtij orari të punës si: numri i patrullimeve, vendi i patrullimit etj. Pas përfundimit të orarit të punës nga mbikëqyrësi i ndërrimi hartohet dhe dorëzohet raporti i punës së këtij ndërrimi. Inspektimi ka treguar se kjo praktikë nuk aplikohet nga të gjitha stacionet policore të inspektuara, pasi që në disa stacione (Gjilan, Ferizaj dhe “Jugu” Prishtinë) nuk kishin hartuar raportin nga ndërrimi paraprak por që aktivitetet e tyre pasqyroheshin vetëm në raportin 24 orësh. Të gjitha stacionet policore kanë prezantuar raportet 24 orësh. (shih tabelën nr. 4)

Tabela nr. 4. Informata lidhur me nxjerrjen e orareve të punës dhe raporteve (14.10.2016)				
Stacioni Policor	Nënshkrimi i vijueshmërisë në punë	Oraret e punës	Raportet e ndërrimit	Raportet 24 orësh
Gjilan	Jo	Po	Jo	Po
Peja	Po	Po	Po	Po
Mitrovica Jugu	Po	Po	Po	Po
Mitrovica Veri	Po	Po	Po	Po
Prizreni	Jo	Po	Po	Po
Leposaviqi	Po	Po	Po	Po
Gjakova	Po	Po	Po	Po
Ferizaj	Jo	Po	Jo	Po
“Veri” Prishtinë	Po	Po	Po	Po
“Jugu” Prishtinë	Jo	Po	Jo	Po
“Qendra” Prishtinë	Jo	Po	Po	Po

### 3.4. Vlerësimi i nivelit të sigurisë të stacioneve policore

3.4.1. Në përmbushjen e kushteve të sigurisë të stacioneve policore, inspektorët janë përqendruar kryesisht në katër kriterë bazë, duke konsideruar se paraqesin disa nga elementet prioritare të sigurisë. Nga 11 stacione të inspektuara, nëntë (9) prej tyre kanë pasur të angazhuar policin e parë apo të sigurisë, shtatë (7) stacione policore kanë të pajisur sistemin e vëzhgimit me kamera, tetë (8) kanë të rregulluar rrethojat rreth stacioneve dhe 11 prej tyre mbajnë evidencat e hyrjeve daljeve në objekt për personat e pa autorizuar.

3.4.2. Meqë inspektorët ishin të ngarkuar me detyrën edhe të dhënies së vlerësimit mbi nivelin e sigurisë në stacione, pesë (5) stacione policore janë vlerësuar me nivel të 'mirë' të sigurisë, katër (4) stacione me nivel të 'mjaftueshëm' të sigurisë si dhe dy (2) stacione (Peja dhe Gjilani) me nivel mjaftueshëm/keq të sigurisë (*shih tabelën nr. 5*). Sa i përket vlerësimit me nivelin mjaftueshëm/keq për dy stacionet policore është marrë për bazë pozita e këtyre stacioneve, ku dihet se të dy këto stacione janë shumë afër rrugës kryesore ku ka frekuentim të madh të qytetarëve dhe nuk kanë fare rrethojë të objektit apo ndonjë pengesë tjetër e cila do ta pengonte hyrjen e pa penguar të qytetarëve në objektin e policisë. Gjithashtu, këto dy stacione policore hapësirën të cilën e shfrytëzojnë për parkingun e automjeteve zyrtare policore e kanë fare pranë rrugës kryesore dhe pa rrethojë, pozitë kjo e cila kërkon prezencën permanente të zyrtarëve policor për sigurimin e automjeteve zyrtare policore.

3.4.3. Përderisa dy stacionet policore të lartcekura janë vlerësuar me nivelin e sigurisë mjaftueshëm/keq për shkak të pozitës së objekteve, dy stacionet tjera policore (Mitrovica "Veri" dhe "Jugu" Prishtinë) edhe pse kanë rrethojë të objektit janë vlerësuar me nivelin "mjaftueshëm" të sigurisë, pasi që në këto dy stacione policore nuk janë të vendosura kamerat e sigurisë si dhe inspektorët kanë gjetur se në këto dy stacione policore nuk ka qenë polici i parë (statiku).

3.4.4. Duke marrë parasysh vlerësimin tre shkallësh të nivelit të sigurisë në stacione, me: 'mirë', 'mjaftueshëm' dhe 'keq', del se përgjithësisht niveli i sigurisë është vlerësuar në nivelin e mjaftueshëm të sigurisë.

Stacioni Policor	Respektimi i masave të sigurisë në objektet e stacioneve policore					
	Polici i parë	Kamerat e sigurisë	Libri i ankesave	Rrethoja e objektit	Regjistri i hyrjeve daljeve	Vlerësimi i inspektorit <sup>2</sup>
Mitrovica Jugu	Po	Po	Po	Po	Po	mirë
Mitrovica Veri	Jo	Jo	Po	Po	Po	mjaftueshëm
Prizren	Po	Po	Po	Po	Po	mirë
Pejë	Po	Po	Po	Jo	Po	mjaftuesh./keq
Leposaviç	Po	Jo	Po	Po	Po	mjaftueshëm
Gjilan	Po	Po	Po	Jo	Po	mjaftuesh./keq
Gjakova	Po	Po	Po	Po	Po	mirë
Ferizaj	Po	Po	Po	Po	Po	mirë
"Veri" Prishtinë	Po	Jo	Po	Po	Po	mjaftueshëm
"Jugu" Prishtinë	Jo	Jo	Po	Po	Po	mjaftueshëm
"Qendra" Prisht.	Po	Po	Po	Po	Po	mirë

<sup>2</sup> Vlerësimi i kryer nga inspektorët sipas tre niveleve: i mirë (3), mjaftueshëm (2) dhe i keq (1).

## 6. PËRFUNDIMET

---

4.1. Në periudhat ku janë zhvilluar vizitat në stacione policore, ndërrimet kanë qenë mjaft mirë të mbuluara me personel për kryerjen e detyrave policore. Mirëpo, Inspektimi ka gjetur se tri (3) stacione policore të cilat kanë pas numër më të madh të punonjësve jashtë detyre (Peja, Ferizaj dhe "Qendra" Prishtinë) si pasojë e pushimeve të ndryshme apo edhe për arsye të angazhimit të personelit në detyra tjera për implementimin e planeve operative (stacioni policor Ferizaj).

4.2. Inspektorët kanë konstatuar se dokumentet relevante që lidhen me oraret e punës dhe raportet e punës janë përpiluar në mënyrën e duhur. Gjatë inspektimit nuk ka qenë në zbatim ndonjë plan i veçantë operacional (përveç në stacioni policor Ferizaj), i cili do të kërkonte angazhim shtesë të kapaciteteve të burimeve njerëzore. Mbikëqyrësit e ndërrimeve kanë prezantuar oraret e angazhimit të personelit, raportet 24 orësh si dhe raportet e ndërrimeve paraprake, por që raportet nga ndërrimet paraprake nuk hartohen në të gjitha stacionet policore.

4.3. Është konstatuar se standardi i uniformës respektohet në masë të mirë nga zyrtarët policor, mirëpo inspektimi ka gjetur në disa raste ku nuk respektohet në nivelin e kënaqshëm standardi i bartjes së uniformës. Sa i përket respektimit të standardeve të bartjes së uniformës është konstatuar se nga 242 zyrtarë policor, bexhin e kanë prezantuar 80 prej tyre; numri identifikues nga i gjithë totali i të kontrolluarve nuk është hasur vetëm te një zyrtarë policor në Stacionin Policor të Ferizajt; për mbajtjen e shufrës së kravatës këtë kriter e kanë plotësuar 142 veta nga gjithsej 242 z. policor; pantallonat zyrtar nuk i ka pasur një zyrtar policor; ndërsa këpucët zyrtarë nuk i kanë pasur dy zyrtarë policor. Sa i përket pjesëve tjera të uniformës (shenja PK/Flamuri; këmisha zyrtarë; kapela) del që ky standard të jetë në nivel të kënaqshëm.

4.4. Standardi i pajisjes së zyrtarëve policorë sa i përket armës së zjarrit dhe këllëfit të armës, është i përmbushur plotësisht. Ndërsa sa i përket pajisjeve tjera respektimi i standardit për pajisjet e nevojshme policore nuk është në nivelin e kënaqshëm, pasi që zyrtarët policor në kohën e inspektimit nuk i kanë poseduar me vete të gjitha pajisjet policore. Mungesa të tyre kishte pothuajse te çdo pajisje por që më e theksuar ishte mungesa me bateri të dorës dhe radios për komunikim.

4.5 Niveli i sigurisë së stacioneve policore është vlerësuar si i kënaqshëm, ku vërehet një angazhim i mirë i zyrtarëve policor. Me gjithat inspektimi ka treguar se në disa stacione policore duhet një përkushtim më i madh sa i përket çështjes së sigurisë, pasi që inspektorët kishin vërejtur se në dy stacione policore nuk ishte prezent polici i parë (statiku) si dhe nuk kishte të vendosura kamera të sigurisë.

## 7. REKOMANDIMET

---

5.1 Në drejtim të përmirësimit dhe ngritjes së vazhdueshme të performancës së personelit policor, IPK-ja nxjerrë për PK-në këto rekomandime kryesore:

1. IPK rekomandon Komandantët e Stacioneve Policore (Ferizaj, "Qendra" Prishtinë, "Jugu" Prishtinë dhe Pejë) që shtojnë kujdesin në menaxhimin e pushimeve si dhe në caktimin e punonjësve në detyrë, në mënyrë që të mos mbetet stacioni pa numrin e nevojshëm të punonjësve.
2. IPK rekomandon Komandantët e Stacioneve Policore që të kërkojnë nga mbikëqyrësit e ndërrimeve të hartojnë raportet lidhur me aktivitetet e ndërrimit.
3. IPK rekomandon Komandantët e Stacioneve Policore që të shtojnë kujdesin ndaj zyrtarëve policor në mënyrë që të respektohet rregullorja 30/2015 Për Standardet e Uniformës, sa i përket bartjes së uniformës dhe pajisjeve tjera policore.
4. IPK rekomandon Menaxhmentin e PK-së që ti pajisë me kamera të sigurisë Stacionet Policore të cilat nuk i posedojnë, njëherit dhe Komandantët e Stacioneve Policore që të jenë më të kujdesshëm lidhur me caktimin e zyrtarit policor në detyrën e policit të parë (statikut).

## 8. PLANI I VEPRIMIT TË PK-së PËR PËRMBUSHJEN E REKOMANDIMEVE TË IPK-së

### Plani i veprimit: DRP Divizioni për Siguri Publike

Nga Divizioni për Siguri Publike & Drejtoria për Planifikim dhe Vlerësim Operacional pas inspektimit të jashtëzakonshëm për vlerësimin e performancës policore gjate fillimit të ndërrimit nga ora 08-16 në Stacionet Policor të kategorisë „ A”, ka njoftuar gjitha DRP-të dhe Komandantet dhe zëvendësit e gjitha Stacionet policore të kategorisë „ A” me të gjeturat dhe rekomandimet e IPK-se, si dhe me Planin e Veprimit për implementimin e tyre.

Në bazë të dhënave të marra nga 11 ( njëmbëdhjetë) Stacionet policore të kategorisë „ A” nëpër gjitha DRP-të, në vazhdim do të paraqiten prioritetet për implementimin i rekomandimeve të IPK-së ne Planin e Veprimit të Divizionit për Siguri Publike.

Nr.	Rekomandimet e IPK-së	<u>Prioriteti</u> I larte I mesëm I ulet	Komentet	Plani i veprimit
<u>1.</u>	IPK- rekomandon Komandantet e Stacioneve Policore (Ferizaj, „Qendra” Prishtinë dhe Pejë), që të shtojnë kujdesin në menaxhimin e pushimeve si dhe në caktimin e punonjësve në detyrë, në mënyrë që të mos mbetet stacioni pa numrin e nevojshëm të punonjësve	<u>I lartë</u>	<p>Pas të gjeturave nga IPK-ja dhe rekomandimeve në Stacionet policore Qendër, Prishtinë dhe Pejë kemi të dhënat si ne vijim:</p> <p><b><u>Stacionin policor, „Qendra”</u></b> Rekomandimi parë ka të bëjë me menaxhimin e pushimeve që në detyrë të prezantojnë numër i mjaftueshëm për të kryer detyrat policore bazë të dhënave të prezantuara ju njoftojmë se: nga numri i përgjithshëm i pjesëtareve të uniformuar prej 174, kanë qenë në pushim 23 zyrtar apo shprehur në përqindje 13.2% e që do të thotë se ky numër i pushimeve të aprovuara nuk paraqet problem në kryerjen e detyrave nga se në baze të parimeve të mëhershme të Policisë është rekomanduar që stafi mund të lirohet në pushim deri në 25 % nga numri i përgjithshëm është në rregulle.</p> <p><b><u>Stacionin Policor Jugu në Prishtinë</u></b> Në raportin e inspektimit të IPK-së të datës 26.10.2016 rreth inspektimit të datës 14.10.2016 në tabelën nr.1, është pasqyruar se numri I personelit në detyrë me datën 14.10.2016 është gjithsej tetë (8), përfshirë një toger dhe një rreshter.</p> <p>Statistika është bazuar vetëm <u>në orarin e ekipit reagues i cili fillon detyrën në ora 07:00</u> ndërsa nuk është përfshirë personeli i cili fillon detyrën nga ora 08:00.</p>	Janë të njoftuara DRP-të lidhur me rekomandimet e IPK-së , dhe baze raporteve të pranuar vërehet se janë duke i dhënë rëndësi të veçantë por çdo here do të janë nën mbikëqyrje edhe të DSP& DPVO-se ku do të kryhen inspektime që ky rekomandim të jete çdo here i implementuar.

			<p><b><u>Në Stacionin Policor ne Prizren</u></b> janë paraqitur ankesa se sipas Sistemit PRIMS menaxhimi i pushimeve NUK mundëson kontroll te duhur për aprovimin e tyre dhe paraqitet si shqetësuese.</p> <p><b><u>Stacioni Policor në Ferizaj</u></b> Jemi të informuar se në po të njëjtën datë nuk ka qenë mungesë e stafit për shkaqe të pushimeve vjetore, me kompensim dhe mjekësore por ka qenë Plan Operativ “Lojërat e Fatit” ku atë ditë inspektorët kanë qenë të njoftuar për planin në fjalë si dhe janë pajisur me një kopje të planit operativ .</p>	
<u>2.</u>	IPK- rekomandon Komandantet e Stacioneve Policore që të kërkojnë nga mbikëqyrësit e nderimeve të hartojnë raportet lidhur me aktivitetet e ndërrimit.	<b><u>I mesëm</u></b>	<p>Nga te dhënat e marra nga stacionet policore vërehet se ky rekomandim në përgjithësi implementohet dhe i kushtohet kujdes lidhur me raportimin mbi aktivitetet ditore.</p> <p>Në fund të çdo ndërrimi përpilohet raporti i patrullave dhe i udhëheqësit të ndërrimit në detyrë.</p>	<p>Divizioni Siguri Publike gjegjësisht DPVO pranon raportet mujore nga DRP-te lidhur me aktivitetet operative</p> <p>Po ashtu raportohet edhe për aktivitetet policore te Stacioneve policore ne kuadër të DRP-ve</p>
<u>3.</u>	IPK- rekomandon Komandantet e Stacioneve Policore që të shtojnë kujdesin ndaj zyrtareve policor në mënyrë që të respektohet rregullorja 30/2015. Për standardet e Uniformës sa i përket bartjes së uniformës dhe pajisjeve tjera policore	<b><u>Mesëm</u></b>	<p>Sipas te dhënave është vërejtur se Mbikëqyrësit e stacioneve policore për përmbushjen e rekomandimit për uniformen dhe të pajisjeve policore kanë kryer inspektime nga stafi komandues me qëllim të identifikimit të pajisjeve të dëmtuara, dhe raportimi sipas procedurës, si dhe veprimi sipas procedurës për disipline te brendshme për shkelësit. Mirëpo janë paraqitur disa shqetësime si vijon:</p> <p><b><u>Stacioni policor veri Prishtine</u></b> <u>Arsyet- Bexhat zyrtar</u> pasi që mbajtësit e tyre nuk funksionojnë. <u>Arsyet- shufra e kravatës</u> hyn nën xhemper, shufrat e kravatës në këtë rast dalin nga funksioni <u>Arsyet- Radio lidhjet</u> gjeneratat e reja te zyrtarëve policor nuk janë të pajisur me radio lidhje, është ne dijeni për këtë DPP-ja. <u>Mbajtëset e baterisë</u> nuk janë të sigurta për mbajtjen e baterisë (kur të ulesh dhe të vraposh për ne rast bateria shume lehtë del nga mbajtësja, në këtë mënyrë edhe mund t`ju humb bateria lehtë policëve.</p> <p><b><u>Stacioni Policor Mitrovicë veri</u></b> nuk i kanë e gjithë zyrtaret policor uniformen e ngarkuar dhe pajisjet qe kërkohen me rregullore 30/2015. Mbikëqyrësve te ekipeve është dhënë urdhër qe te bëjnë listën e te gjithë zyrtareve policore cilët nuk kane uniformen e ngarkuar dhe pajisje , qe kërkohet me rregulloren 30/2015 dhe kontrole e bartjes se pajisjes ne detyre para fillimit te ndërrimit . <b><u>Stacioni Policor Gjakovë</u></b> Është përpiluar lista e zyrtareve policore qe kane vështirësi me uniformen e re (numrat jo adekuat) -Janë përcaktuar oraret për te dërguar për furnizim gjithë zyrtaret qe kane vështirësi ne depon kryesore te furnizimit ne Flote. (ri-matje</p>	<p>Po ashtu edhe ky rekomandim është ne përfundim te implementimit dhe po ashtu edhe DSP7 DPVO do te monitoroje implementimin e rekomandimit dhe do te kontaktoje me drejtorin e Logjistikës.</p>

			<p>uniforme)          -Uniforma e vjetër është ne proces pranimit/dorëzimit për gjithë zyrtarët policor.          Është kryer furnizimi me uniformen e re gjithë personeli është ne proces te përfundimit te plot.  <u><b>Stacioni Policor Gjilan</b></u>          Janë ndërmarrë masa që përmes logjistikës të sigurojmë pajisjet e munguara për zyrtarët policor</p>	
<b>4.</b>	<p>IPK rekomandon Menaxhmentin e P.K-së që të i pajis me kamera të Sigurisë Stacionet Policore të cilat nuk i posedojnë, njëherit dhe Komandantët e Stacioneve Policore që të jenë më të kujdesshëm lidhur me caktimin e zyrtarit policor në detyrën e policit të parë ( statikut)</p>	<b>I lartë</b>	<p><u><b>Stacioni Policor veriu</b></u>  <b>Veprimi – kamerat e sigurisë</b>          Ju njoftojmë se me 02.11.2016 është bërë një kërkesë me shkrim organeve përgjegjëse që kërkesa dhe rekomandimi i dhënë të analizohen dhe mundësisht në bashkëpunim me njësitet përkatëse të aprovohet kjo kërkesë dhe rekomandim.          Gjithashtu pas rekomandimeve të bere dhe vlerësimit të situatës në teren në pikën statike janë te vendosur nga 2 policë.</p> <p><b>3. Stacioni Policor jugu</b>          Ndaj zyrtarit policor i cili me datën e inspektimit nuk është gjetur në vendin e caktuar /statik në hyrje të Stacionit do të ndërmerren masa në përputhje me Udhëzimin Administrativ 06/2012 Për shkeljet , masa dhe procedurat disiplinore në Policin e Kosovës</p> <p>Gjithashtu në planin e inspektimit menxhmenti i Stacionit Policor Jugu të përfshij inspektimin e zyrtarëve policor të caktuar në detyrën e policit të parë (statik) . Inspektimet do të përfshijnë kryesisht. ndërrimin e mbrëmjes dhe natën. Inspektimi do të realizohet në periudhën 11.11.2016-30.11.2016 me mundësi vazhdimi. Eprorët që kryej inspektimin duhet të përpilojnë raportin mbi inspektimit dhe në çdo rast të parregullsive në fushën në fjalë duhet të ndërmerren masa ndaj zyrtarit që është hasur në kundërshtim me detyrën e caktuar.</p> <p>Pas kontrollës nga ana e IPK-es i është dorëzuar kërkesa për Logjistik e <u>DRP Mitrovica-veri</u> ne korrigjimin e këtij problemi . Gjithashtu është dhënë urdhër mbikëqyrësve te ekipeve patrulluese qe sa me shpesh kryen kontrollin e zyrtarëve policore te cilët punojnë ne sigurimin e portës ne hyrjen e SP Mitrovica-veri          Objekte dhe parkingu për veturat zyrtare cilët shfrytëzon <u>SP Mitrovica-veri</u> , janë te mbuluara me kamera te cilët i kontrollon OSCE dhe shtëpia e EU ne te cilën PK nuk ka qasje .          Edhe njëherë janë rivendos kërkesat për kamera ne stacionin policore ne Leposaviq dhe Mitrovicë veri</p>	<p>DSP&amp;DPVO do te kërkoj nga TIK-u DPP të do të njoftohet me rekomandimet dhe njëkohësisht do te kërkohej qe te kontrollohen pajisjet e kamerave ne stacione policore për funksionimin e tyre dhe furnizimin me to ku ato mungojnë.</p>